

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6639
E shtunë, 25 qershor 2022
çmimi 0.40 €

PROF. DR. EQREM ZENELAJ,
ATDHETARI DHE AKADEMIKU
ME PËRMASA NDËRKOMBËTARE
QË MBAN TITULLIN "KALORËS I
URDHRIT TË SKËNDERBEUT"

Njerëzit e mëdhenj nuk lindin të mëdhenj,
por bëhen të mëdhenj

Major Mark
ZefMARKU



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PUBLIKOHEN KONKLuzionET PËRFUNDIMTARE NGA SAMITI I BRUKSELIT, ASNJË SHENJË PËR HEQJEN E VIZAVE

FAQE 4-5



Në takim dyditor të liderëve të 27 vendeve të BE-së në Bruksel s'ka pasur asnjë rezultat konkret sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën. Këshilli i Bashkimit Evropian (BE), i cili është

mbledhur të enjten dhe të premten, ka publikuar konkluzionet përfundimtare nga takimi, kurse heqja e vizave për Kosovën nuk është përmendur askund

OPINION

FILOZOFIA DHE ETIKA POLITIKE
E REXHEP QOSJES F.7

Prof. ass. dr. SABRI
KIÇMARI



AKTUALE



GUTERRES: BOTA PO PËRBALLET
ME NJË KRIZË TË PAPRECEDENTË
URIE F.3

MOSLIBERALIZIMI I VIZAVE,
"MARAKLI T'BICIKLAVE"
PROTESTUAN PARA QEVERISË F.3

KURTI PREMTON PËRMIRËSIMIN E
GJENDJES SOCIO-EKONOMIKE PËR
KOMUNITETIN EGJIPTIAN F.6

EKONOMI

POLICIA PARANDALON
KONTRABANDIM TË PEMËVE,
PERIMEVE DHE DRURËVE F.8

ATK-ja PARAQET PROJEKTIN PËR
TRAJTIMIN E MALLIT PA ORIGJINË
DHE MUNGESËS NË STOQE F.8

SPORT



KUPA E BOTËS 2022:
10 NDESHJE TË FAZËS SË GRUPEVE
QË NUK DUHEN HUMBUR F.10



"ELEKTROSEVERI"
LICENCOHET PËR
FURNIZIMIN E VERIUT
ME RRYMË

FAQE 8



PSD-ja, AKSION KUNDËR
PROJEKTLIGJIT PËR
KËSHILLIN PROKURORIAL

FAQE 3

POLICIA NDËRMERR
AKSION NË DISA
SHKOLLA NË FERIZAJ,
GJEN ARMË DHE THIKA



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Guterres: Bota po përballet me një krizë të paprecedentë urie

NJU-JORK, 24 QERSHOR - Të premtën sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, deklaroi se këtë vit ekziston një "rrezik real" i krizave të shumëfishta të urisë dhe kërkoi, në mbledhjen e ministrave për sigurinë ushqimore, që të ndërmerren hapa praktikë për t'i stabilizuar tregjet ushqimore dhe për ta zvogëluar paqëndrueshmërinë e çmimeve të mallrave.

"Ne përballemi me një krizë urie të paprecedentë", tha Guterres në takimin virtual të zhvilluar në Berlin. Ai ka theksuar se lufta në Ukrainë ka komplikuar edhe më shumë problemet që kanë lindur prej vitesh: ndryshimet e klimës, pandemia Covid-19, rimëkëmbja thellësisht e pabarabartë.

Më shumë se 460 000 njerëz në Somali, Jemen dhe Sudanin Jugor janë në kushte urie ekstreme, sipas Klasifikimit të Fazës së

Sigurisë Ushqimore të Integruar (IPC) - një shkallë e përdorur nga agjencitë e OKB-së, organet rajonale dhe grupet e ndihmës për ta përcaktuar pasigurinë ushqimore. Ky është hapi përpara shpalljes së urisë në një rajon. Miliona njerëz në 34 shtete janë në prag të urisë sipas statistikave të IPC-së.

"Ekziston një rrezik real që shumë shtete do të deklarojnë krizë urie në vitin 2022. Dhe viti 2023 mund të jetë edhe më keq", tha Guterres, duke e cilësuar si të papranueshëm urinë masive dhe krizat ushqimore në shekullin e 21-të.

Guterres tha se nuk do të kishte një zgjidhje efektive të krizës, vetëm nëse Ukraina dhe Rusia, të cilat prodhojnë së bashku rreth 29 % të eksporteve të drithërave, gjejnë një rrugëdalje për ta rifilluar tregtinë.

Dërgesat nga portet e Ukrainës janë ndaluar që nga nisja e



pushtimit të Rusisë ndaj fqinjët të saj. Moskë dëshiron që të hiqen disa sanksione perëndimore në mënyrë që të rifillojë eksportet e saj të grurit dhe plehrave bujqësore.

Kombet e Bashkuara dhe Turqia po përpiqen të ndërmjetësojnë një marrëveshje.

Guterres nuk dha detaje mbi bisedimet, duke thënë: "Deklaratat

publike mund ta pengojnë suksesin e negociatave". Ai u kërkoi ministrave në takimin e Berlinit që ta adresojnë krizën financiare në vendet në zhvillim.

Rusia: Statusi kandidat për Ukrainën, një 'çështje e brendshme' e BE-së



MOSKË, 24 QERSHOR - Kremli tha të premtën se vendimi i Bashkimit Evropian për t'ia dhënë statusin e kandidatit Ukrainës, aty ku Rusia po zhvillon një fushatë ushtarake, është tërësisht "një çështje e brendshme" e unionit. "Këto janë, natyrisht, çështje të brendshme evropiane", u tha Peskov gazetarëve në një konferencë për mediet. "Për ne është thelbësore që të gjitha këto procese të mos sjellin më shumë

probleme të ne dhe në marrëdhëniet e vendeve të lartpërmendura me ne. Dhe se kjo nuk çon në një përqendrim të mëtejshëm të marrëdhënieve tona me BE-në".

Gjithashtu, të premtën, edhe ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov, tha se perspektiva evropiane e Ukrainës dhe Moldavisë nuk përbënte "rrezik" për Rusinë pasi, sipas tij, BE-ja nuk është një aleancë ushtarake. Megjithatë, ai i akuzoi

BE-në dhe NATO-n se po mbledhin një "koalicion" për t'u përgatitur për një luftë me Rusinë, duke i krahasuar ato me aleancën naziste të Luftës së Dytë Botërore. "Hitleri nën flamurin e tij kishte bashkuar një pjesë të madhe të vendeve evropiane për të luftuar kundër Bashkimit Sovjetik", tha Lavrovi gjatë një vizite pune në Azerbajxhan. "Sot BE-ja dhe NATO po bashkojnë një koalicion të tillë për të bërë luftë kundër Rusisë".

Marrëdhëniet e Rusisë me Perëndimin kanë qenë në nivelin më të ulët që kur presidenti Vladimir Putin dërgoi trupa në Ukrainë, duke shkaktuar edhe një breshëri sanksionesh të vendosura ndaj Moskës.

Udhëheqësit e BE-së i dhanë të enjten statusin e kandidatit Ukrainës dhe Moldavisë, por thanë se Gjeorgjia, e cila aplikoi për anëtarësim, mund ta marrë këtë status vetëm pasi të trajtohen çështjet e pazgjidhura.

Bullgaria kritikon Ramën mbi gjuhën e përdorur në samitin e BE-së

SOFJE, 24 QERSHOR - Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Bullgarisë ka publikuar të premtën një deklaratë të ashpër kundër kryeministrit shqiptar Edi Rama pas deklaratave të këtij të fundit, i cili tha se Bullgaria po mban peng Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në lidhje me moshapjen e negociatave me Bashkimin Evropian.

Në një deklaratë të gjatë, Ministria e Punëve të Jashtme bullgare kujtoi se ka qenë "gjithmonë ndër ato shtete anëtare të BE-së që mbështesin identitetin evropian të popullit shqiptar", ndërsa akuzoi kryeministrin Rama për "komente të rënda dhe fyese".

Më tej, në deklaratë thuhet se gjuha e përdorur nga kreu i qeverisë shqiptare nuk mund të justifikohet, teksa shton se Rama duhet të flasë

si një politikan i një vendi kandidat për në BE. "Bullgaria gjithmonë ka qenë mes shteteve anëtare të BE-së që ka mbështetur integrimin e popullit shqiptar. Kemi mbrojtur perspektivën evropiane të Shqipërisë dhe nisjen e bisedimeve, edhe kur ishte shumë më e vështirë sesa sot. Përgjatë viteve nuk ka pasur shumë zëra të tjerë krahas nesh. Edhe sot, pavarësisht gjithçkaje, i qëndrojmë kësaj ideje, në emër të një të ardhmeje të përbashkët evropiane", thuhet në një reagim zyrtar të Ministrisë së Jashtme të Bullgarisë. "Nuk është hera e parë që kemi dëgjuar ofendime të pamërituara nga kreu i një qeverie. Një gjuhë e tillë nuk mund të justifikohet. Presim që kryeministri i Shqipërisë ta moderojë gjuhën, duke e bërë të përshtatshme për

politikanin e një vendi kandidat për në BE. Në këtë pikë, këmbëngulim që të ruajmë një ton të mirë komunikimi. Ne kemi të ardhme të përbashkët me Shqipërinë. Politikanët shkojnë e vijnë, kombet mbeten. Popujt tanë kanë një interes të përbashkët, që nuk duhet të minohet nga gjykimet e gabuara. Është e papranueshme që marrëdhëniet mes dy shteteve të mbeten peng të sjelljes së kryeministrit të Shqipërisë".

Kryeministri Edi Rama nuk ka vonuar të kundërreagojë ndaj deklaratës së Ministrisë së Jashtme të Bullgarisë, duke thënë se edhe ai ka një problem me Bullgarinë se si dëshiron t'i zgjidhë çështjet dypalëshe. Ai ka thënë se Bullgaria ose duhet ta heqë veton, ose duhet ta durojë atë. "Oh! Ministria e Jashtme e Bullgarisë ka problem



me mënyrën time të të folurit. E drejtë. Edhe unë kam një problem me mënyrën se si Bullgaria dëshiron t'i zgjidhë çështjet dypalëshe duke përdorur procesin e zgjerimit si mjet për të marrë peng dy vende të NATO-s. Qetësohuni miq: Hiqeni veton, ose më duroni!", ka shkruar Rama në

"Twitter".

Pas zyrtarizimit të vendimit për të mos marrë një datë për negociatat, Rama ka thënë se Bashkimi Evropian është shndërruar në një realitet qesharak pasi shtetet më të fuqishme të botës kanë ngrirë për shkak të problemeve të një tjetër vendi.

PSD-ja, aksion kundër Projektligjit për Këshillin Prokurorial

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Partia Socialdemokrate ka drejtuar akuza në drejtim të Lëvizjes Vetëvendosje pas votimit në parim të Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Ky subjekt politik përmes një aksioni të premtën ka denoncuar ndryshimet legislative mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës që janë votuar dje në lexim të dytë nga deputetët e pushtetit. "Me këto ndryshime legislative, vendimmarrja mbi çështje të rëndësishme të këtij Këshilli (votimi për Kryeprokurorin e Shtetit, Kryeprokurorët e Prokurorive dhe çështjet disiplinore) do jetë e kushtëzuar nga vullneti politik, përkatësisht nga vota e anëtarëve joprokurorë të këtij organi. Amendamenti 9 i dorëzuar në lexim të dytë e vulos ndikimin e anëtarëve joprokurorë kundrejt atyre që vijnë nga sistemi prokurorial. Mos të harrojmë se

këto ndryshime legislative deri më tani janë ballafaquar me vërejtje serioze nga Komisioni i Venecias, por edhe nga shoqëria civile. Të gjitha këto vërejtje kanë një emërues të përbashkët – shqetësimin mbi kontrollin politik të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Për fatin tonë të keq, këto shqetësime nga dje u bënë realitet", është thënë në reagimin e PSD-së.

Duke theksuar se tash ky Këshill shumë shpejt do jetë nën kontrollin politik të pushtetit të Kurtit. "Ky cenim kaq serioz i pavarësisë së sistemit prokurorial do të zhvillohet vetëm në dëm të drejtave fundamentale të njeriut e në shërbim të pushtetit 'Krejt dhe drejt'. Sigurisht, organet e sistemit të drejtësisë vuajnë nga shumë probleme e parregullsi, por politizimi i tyre nuk është mënyrë për t'i adresuar këto probleme. Veçanërisht shqetësuese bëhet situata kur flitet për organin e akuzës. Kapja e sistemit prokurorial do t'ia mundësojë



pushtetit arrestimet spektakolare dhe damkosjen e njerëzve duke i shpallur fajtorë pa vendim merit të gjykatës Politizimi i

organit të akuzës shkon përkundër prezumimit të pafajësisë dhe parimit të legalitetit. Ky fenomen duhet të

jetë shqetësim publik, dhe jo thjesht punë e profesionistëve", është theksuar në reagimin e PSD-së.

ATK-ja paraqet projektin për trajtimin e mallit pa origjinë dhe mungesës në stoqe

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka bërë me dije se projekti i radhës i cili nis së implementuari është projekti i përmbushjes "Mungesa në stoqe dhe malli pa origjinë", i cili ka për qëllim ta përmirësojë përmbushjen tatimore në sektorin e tregtisë me shumicë, duke përfshirë të gjithë faktorët që ndikojnë dhe ndikohen nga ky sektor në mënyrë më të fokusuar dhe më të koordinuar.

Grupet e synuara për trajtim përmes këtij projekti janë: industria e tekstilit, tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, tregtia me shumicë e artikujve

shtëpiakë, tregtia tjetër me shumicë e specializuar, tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara, tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara dhe të tjera. "Ekziston ende një numër i konsiderueshëm i tatimpaguesve të cilët kanë problemin e mallit pa origjinë si rezultat i blerjeve pa fatura, po ashtu shitje të padeklaruara", thuhet në njoftimin për medie.

Bazuar në të dhënat e përmbushjes gjatë vitit 2021, shihet se edhe dukuria e mallit pa origjinë dhe mungesës në stoqe renditet ndër dukuritë me nivel të lartë të riskut dhe janë identifikuar si aktivitete më me risk.



Mosliberalizimi i vizave, "Marakli t'biciklave" protestuan para qeverisë

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Disa qytetarë të premtën kanë marshuar dhe protestuar nga sheshi "Zahir Pajaziti" deri te sheshi "Skënderbeu". Ata kanë kërkuar liberalizimin e vizave me moton "Free Visa

for Kosovo" drejtuar Bashkimit Evropian (BE). Ata dolën për të protestuar me biçikleta, duke mbajtur në duar flamurin e Kosovës, i rrethuar me tela gjemborë, për të treguar "Kosovën e izoluar". Një ditë më parë

qytetarët e Kosovës shpresuan se në Samitin e Bashkimit Evropian me liderët e Ballkanit Perëndimor do të futej në diskutim edhe tema për liberalizim të vizave për Kosovën, e cila nuk ndodhi.





Publikohen konkluzionet përfundimtare nga samiti i Brukselit, asnjë shenjë për heqjen e vizave

Në takim dyditor të liderëve të 27 vendeve të BE-së në Bruksel s'ka pasur asnjë rezultat konkret sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën. Këshilli i Bashkimit Evropian (BE), i cili është mbledhur të enjten dhe të premten, ka publikuar konkluzionet përfundimtare nga takimi, kurse heqja e vizave për Kosovën nuk është përmendur askund

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Në takim dyditor të liderëve të 27 vendeve të BE-së në Bruksel s'ka pasur asnjë rezultat konkret sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën. Qytetarët e Kosovës janë zhgënjyer edhe një herë, për t'i vazhduar pritjet e

pafundme para ambasadave. Këshilli i Bashkimit Evropian (BE), i cili është mbledhur të enjten dhe të premten, ka publikuar konkluzionet përfundimtare nga takimi, kurse heqja e vizave për Kosovën nuk është përmendur askund.

Krejt çfarë është thënë për Kosovën në këtë dokument është urgjenca që Kosova dhe Serbia të bëjnë përparim në normalizimin e marrëdhënieve përmes dialogut. "Këshilli Evropian ripohon urgjencën për të bërë përparim të prekshëm në

zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pazgjidhura dypalëshe dhe rajonale, veçanërisht dialogu Beograd - Prishtinë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës", është thënë në konkluzionet e Këshillit të BE-së. Pritjet që liberalizimi i vizave të diskutohet në takim dyditor të Këshillit të BE-së nuk është realizuar, madje çështja as nuk është përfshirë në konkluzionet përfundimtare të Këshillit. Heqja e vizave për qytetarët e

Kosovës nuk është përmendur as në konferencën e përbashkët të presidentit të Këshillit të BE-së, Charles Michel, presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen dhe presidentit francez Emmanuel Macron. Kosova është përmendur vetëm nga presidenti i Këshillit të BE-së, Charles Michel, në kontekstin e përkrahjes së dialogut Prishtinë - Beograd. "Ne përkrahim konkluzionet nga përfaqësuesi i lartë në dialogun në mes të Prishtinës dhe

50 zyrtarët e rinj korrektues nga e hëna nisin trajnimin shtatëmujor

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Të premten, në një ceremoni të organizuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, 50 kandidatë për zyrtarë korrektues të rinj, të gjeneratës së 42-të,

nënshkruan kontratat me Shërbimin Korrektues të Kosovës. Zyrtarët e rinj nga e hëna do ta fillojnë trajnimin shtatëmujor në Akademinë e Kosovës për Siguri

Publike, ndërsa pas përfundimit pritet ta fillojnë angazhimin e tyre në Burgun e Sigurisë së Lartë, Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë dhe në Qendrën Korrektuese të Dubravës.

Në ceremoni morën pjesë ministrija e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, zëvendësuesi i drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues, Sami Gashi dhe zyrtarë të lartë të ShKK-së.



Osmani kërkon përkrahjen e Tajlandës në procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të vizitës në Tajlandë, është takuar me kryeministrin e Tajlandës, Prayut Chan-o-cha, me të cilin fokusi i bisedës ishte forcimi i marrëdhënieve ndërshtetërore. Presidentja Osmani ka falënderuar kryeministrin e Tajlandës për mbështetjen e këtij shteti ndaj Kosovës dhe, në të njëjtën kohë, ka kërkuar përkrahjen në procesin e

anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Në takim me kryeministrin e Tajlandës, presidentja ka theksuar se Kosova e sheh këtë shtet si aleat në këtë pjesë të botës, ndaj është e interesuar që edhe me ndihmën e saj të ndërtojë marrëdhënie miqësore me shtetet e Azisë Juglindore. Presidentja Osmani në këtë takim ka paraqitur mundësinë dhe potencialin që ofron Kosova për investitorë të jashtëm, duke

përmendur popullsinë e re dhe të arsimuar si asetin kryesor shtetëror. Për ta lehtësuar bashkëpunimin ekonomik me këtë shtet, presidentja Osmani ka theksuar nevojën e marrëveshjes për mbrojtje të investimeve dhe për eliminimin e taksimit të dyfishtë. Në këtë kontekst, presidentja është angazhuar për rritjen e shkëmbimit të mallrave dhe lëvizjes së qytetarëve në mes të dy vendeve.



Beogradit", ka thënë ai kur ka folur për shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Ndërsa kryeministri holandez, Mark Rutte, shteti i të cilit është skeptik sa i përket heqjes së vizave, në takimin e parë të Këshillit dje, ka thënë se Kosova ka shënuar përparim, por jo mjaftueshëm sa të ndodhë liberalizimi.

Në anën tjetër, presidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, mbetet liderja e vetme evropiane që ka përmendur domosdoshmërinë e liberalizimit të vizave për Kosovën. Metsola para fillimit të

Samitit BE - Ballkani Perëndimor, dhe pas përfundimit të samitit, ka thënë se Kosovës duhet t'i hiqen vizat. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka mbajtur fjalim në takimin e liderëve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, ku ka theksuar se populli i Kosovës ndihet i diskriminuar pa liberalizim të vizave, pavarësisht se është populli më proevropian. "Ata dëshirojnë një regjim pa viza, për të parë, ndier dhe përjetuar Evropën. Kjo, thjesht, ka shkuar shumë larg. Qytetarët e mi ndihen të diskriminuar

pavarësisht se janë më proevropianët dhe i plotësojnë të gjitha kriteret prej katër vjetësh. Ata mbeten të izoluar në zemër të kontinentit ku jetojnë. Ironia është që ne jemi këtu si anëtarë të barabartë të komunitetit ndërkombëtar, duke diskutuar për agjendën evropiane, por sigurisht që unë ulem mes jush sot këtu si i vetmi person në këtë tryezë që duhet të marr një vizë për të marrë pjesë në këtë samit. Për t'i vënë gjërat në perspektivë, ka liberalizim të vizave për vendet e largëta si Venezuela, por qytetarët e Kosovës që jetojnë në një distancë të shkurtër me

makinë, që jetojnë në fqinjësinë tuaj, nuk mund të udhëtojnë lirshëm. Kjo është një padrejtësi e madhe. Kosova ka bërë pjesën e saj, tani është radha juaj", ka thënë Osmani.

Pas përfundimit të samitit ajo tha se ka dëgjuar shumë deklarata pozitive për Kosovën nga liderët e BE-së. "Kemi dëgjuar deklarata mbështetëse për Kosovën, së pari për perspektivën e qartë në BE dhe liberalizimin e vizave. Por, tani na duhet të shkojmë nga fjalët në vepra", ka thënë ajo. Sipas Osmanit, kësaj radhe ka pasur edhe më shumë deklarata mbështetëse për liberalizimin e

vizave sesa më herët. "Duhet të them se këto kanë qenë deklarata më pozitive që i kemi dëgjuar deri më tani për liberalizimin e vizave. Edhe shtetet që kanë qenë hezituese, shumë prej tyre kanë treguar mbështetje sot", ka deklaruar Osmani.

Takimi tjetër i 27 liderëve të unionit sipas kalendarit të Këshillit të BE-së do të zhvillohet më 20 dhe 21 tetor 2022. Franca ka udhëhequr Presidencën e Këshillit të BE-së nga 1 janari 2022 dhe do ta përfundojë atë më 30 qershor 2022 për ta dorëzuar te Çekia nga 1 korriku.

"Kosova dhe Gjermania janë të lidhura ngushtë dhe miqësisht"

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premtën në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde.

Konjufca e ka falënderuar ambasadorin Rohde për mbështetjen e vazhdueshme që Gjermania i ka dhënë Kosovës para, gjatë dhe pas luftës. Në

këtë kontekst, Konjufca ka theksuar se shteti gjerman është dëshmuar aleat dhe partner i rëndësishëm i Republikës së Kosovës në të gjitha proceset e shtetndërtimit, zhvillimit dhe integritit.

Ambasadori Rohde u shpreh se Kosova dhe Gjermania janë të lidhura ngushtë dhe miqësisht mes vete, duke konfirmuar

vazhdimin e mbështetjes dhe angazhimit të përbashkët për perspektivën e Kosovës në familjen e shteteve evropiane. Në takim u ritheksua gatishmëria për thellimin e bashkëpunimit dhe forcimin e mëturjes së marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë.



Breshri u shkaktoi dëme të mëdha bujqve në Gjilan

GJILAN, 24 QERSHOR (ER) - Breshëri dhe erërat e fuqishme kanë përfshirë edhe komunën e Gjilanit ditët e fundit. Në disa zona bujqësore kanë shkaktuar edhe dëme. Drejtori i Bujqësisë, Bajram Isufi, i ka ftuar fermerët t'i raportojnë dëmet nga fatkeqësitë natyrore në

mënyrë që të shënohen në raportin i cili do t'i përcillet Ministrisë së Bujqësisë. "Të gjithë fermerët e komunës së Gjilanit të cilët kanë pësuar dëme në sektorin e bujqësisë nga fatkeqësitë natyrore, siç janë erërat e forta dhe breshëri, duhet të paraqiten në Drejtorinë e

Bujqësisë dhe Pylltarisë. Komisioni i emëruar nga Drejtoria do të dalë në vendin e ngjarjes për t'i mbledhur të dhënat dhe bërë evidentimin e tyre në raportin i cili do t'i përcillet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për procedim të mëtejshëm", ka thënë Isufi.



Kurti premton përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike për komunitetin egjiptian

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Në Ditën Memoriale të Komunitetit Egjiptian në Kosovë, kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim profesionistë nga ky komunitet. Në takimin e përbashkët me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, u bisedua për pozitën e komunitetit egjiptian në shoqëri. Duke vlerësuar bashkëpunimin shumë të mirë të deritanishëm, kryeministri Kurti theksoi angazhimin e vazhdueshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të

këtij komuniteti. Kryeministri ka potencuar nismat e qeverisë që do të ndikojnë në rritjen e mundësive për edukim dhe punësim të komunitetit egjiptian. Ai veçoi bursat për studime në Fakultet të Edukimit dhe në drejtime të tjera të studimeve, si dhe hapin e rëndësishëm drejt realizimit të kuotës për punësim në institucione, vendimin për krijimin e ekipit ndërinstitucional për punësimin e komuniteteve. Gjatë takimit u vlerësua puna e qeverisë dhe u theksua impakti që ka pasur në grupe të ndryshme në Kosovë.



Drejtorja e Shëndetësisë në Mitrovicë përfiton donacion 12 mijë euro nga OJQ "ASB"



Mitrovicë, 24 qershor (ER) - Nënkrjetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, ka pritur të premten në takim drejtoreshën ekzekutive të OJQ-së "Arbeiter-Samariter-Bund (ASB)", Dafina Hoxha, së bashku me bashkëpunëtorin e saj. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Fahri Shabani dhe drejtori Elvis Feka. Qëllimi i këtij takimi ishte informimi rreth dhurimit të donacionit në vlerë prej 11 mijë e 500 eurosh, i cili i dedikohet Drejtorisë së Shëndetësisë me


pajisje dhe aparatura për nevoja të QKMF-së. Gjatë takimit të dyja palët janë përcaktuar rreth hapave të mëtejshëm deri te finalizimin i pranim-dorëzimit të këtij donacioni që pritet të bëhet së shpejti. Me këtë rast, nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, ka falënderuar përfaqësuesit e kësaj organizate për dhurimin e këtij donacioni për shëndetësinë e Mitrovicës, duke theksuar ndikimin që do të kenë këto pajisje për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në QKMF.

Policia ndërmerr aksion në disa shkolla në Ferizaj, gjen armë dhe thika

FERIZAJ, 24 QERSHOR (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj, përkatësisht Sektori Rajonal i Hetimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit të komunës së Ferizajt dhe me autorizim të Prokurorisë Themelore të Ferizajt, mbi bazën e disa informacioneve që ka pranuar rreth dukurive negative të nxënësve dhe personave të tjerë në shkolla dhe përreth tyre, që në fillim të muajit shkurt 2022 ka nisur aksionin e koduar "Siguria në

shkolla 2022". Në kuadër të këtij plani, pas disa kontrolleve të zhvilluara nga hetues rajonalë me rroba civile, të mbështetur edhe nga njësi të tjera, kanë ndaluar dhe kontrolluar shumë nxënës në afërsi të shkollave dhe persona të tjerë në rrugë të ndryshme të qytetit. Gjithashtu, janë bastisur dhe kontrolluar disa lokale, shtëpi dhe objekte përcjellëse, ku si prova materiale janë gjetur dhe konfiskuar: armë zjarri (pistoleta), pesë (5); armë të

gjata gjysmautomatike dy; sasi e municionit; thika - 40 copa, kryesisht të nxënësve të shkollave të mesme; boksa të metalit, 10 copë, të nxënësve të shkollave të mesme; mulli për bluarje të marijuanës 6 copë; shufra metali, 4 copë dhe elektroskok, 1 copë. Ndërsa janë ndaluar dhe shoqëruar në polici dyzet persona me dyshimin se kanë përdorur narkotikë dhe ndaj tyre janë iniciuar raste në Prokurorinë dhe Gjykatën Themelore të Ferizajt.



Gjithashtu, janë ndaluar dhe shoqëruar në polici edhe njëzet persona me dyshimin se kanë shitur narkotikë

(marijuanë) dhe ndaj tyre janë iniciuar raste penale për Prokurorinë Themelore të Ferizajt.

Filozofia dhe etika politike e Rexhep Qosjes



Prof. ass. dr. SABRI KIÇMARI

1. Hyrje

Duhet të ketë qenë vjeshta e vitit 1995 kur e kam parë për herë të parë akademik Rexhep Qosjen në një orë letrare. Me një mjekër të zezë e karakteristike, me trupin drejt dhe kokën lart, kur hyri në sallën e Fakultetit Filozofik, ku mbahej ora letrare, salla u elektrizua nga duartrokitje frenetike. Kishite diçka sokratiane në këtë skenë. Ai ishte bërë simboli karizmatik i dijetarit, të cilin ne, të rinjtë dhe të rejtat veprimtarë për Republikën e Kosovës, e konsideronim se është “në anën tonë, në anën e Republikës.” Diçka e tillë nuk ishte e rëndomtë në atë kohë.

Sociologu francez Pierre Bourdieu duke analizuar ambientin social në një shoqëri në mesin e katër formave të kapitalit e definoi edhe kapitalin kulturor. Ai e dallon kapitalin kulturor nga ai ekonomik, social dhe simbolik. Nuk ka asnjë personalitet në botën intelektuale shoqërore në Kosovë të jetë i pajisur me më shumë vlera etike e kulturore se sa akademik Rexhep Qosja. Në krijimin e këtij kapitali vleror, profesor Qosja është ndeshur me kundërshti, arrogancë të pushtetit, përndjekje dhe dhunë të hapur psikologjike. Rezistenca e tij ndaj të padrejtës, robërisë dhe pabarazisë e ka shndërruar atë në simbol të dinjitetit intelektual ndër shqiptarë.

Figura karizmatike e Rexhep Qosjes është krijuar nëpër decenie për të marrë karakterin e një prej personaliteteve më të shquara të botës shkencore, politike dhe shoqërore ndër shqiptarë. I lindur më 25 qershor 1936 në Vuthaj, në Krahinën e Malësisë, ku mbaroi klasën e para të fillores dhe pastaj gjysmëmatoren në Gusi, si djalë i ri u vendos fillimisht në Mitrovicë dhe pastaj në Prishtinë. Prishtina dhe Vuthaj do ta përcjellin gjatë gjithë jetës së tij si ambiente jetësore, me gjithë dallimet e mëdha të tyre. Çdo verë profesori do të shkojë në Vuthaj, për të shijuar ajrin e pastër të bjeshkëve dhe për të përjetuar dashurinë e pamasë të malësorëve, kurse në kohë pune e semestrash do të kalojë në mesin e studentëve, pedagogëve, studiuesve dhe veprimtarëve për liri.

Profesor Qosja ka shkruar disa dhjetëra libra me studime letrare, kritikë letrare, romane, tregime, drama, recensione, vështrime, trajtesa, artikuj, sprova dhe punime politikologjike. Disa nga librat e tij janë botuar në gjuhë të

ndryshme si në anglisht, gjermanisht, frëngjisht dhe gjuhë të tjera. Të njohur më së shumti e ka bërë libri i tij “Vdekja më vjen prej syve të tillë”. Ky nuk është një roman i thjeshtë. Ai është paraqitja e një tabloje të zymtë të jetës së shqiptarit në Kosovë. Në të ai përshkruan jetën e rëndë nën kontrollin policor të regjimit të Lidhjes Komuniste. Ndeshja morale në mes të Danjollit të Sherkes, si shërbëtor i pushtetit, dhe Xhezairit të Xhikës, ka karakter moral, politik dhe human. Përshkrimi i gjendjes së zymtë nën robëri, përcjellë një mesazh politik vleror për lexuesin që do të mund të përmbledhë në një thirrje për veprim: Kjo gjendje nuk durohet më! Këtë gjendje duhet ndryshuar! Sistemi diktatorial, me sytë e tij që vrasin, duhet zhbërë, duke punuar për të krijuar sistemin e lirisë individuale dhe kolektive.

Shkrimtari ynë i njohur Isamil Kadare duke ja paraqitur këtë vepër publikut francez ka shkruar: “Vdekja më vjen prej syve të tillë” është një vepër me inspirim kafkian, një roman që prish qetësinë, një vepër që profetizon apokalipsin dhe një nga veprat më të mëdha të letërsisë shqiptare.”

Por, Rexhep Qosja nuk është vetëm romancier, dramaturg dhe studiues i letërsisë. Ai është edhe një ndër politikologët tanë më të mirë. Në veprat e tij “Strategjia e bashkimit shqiptar”, “Çështja shqiptare - Historia dhe politika”, “Fjalor Demokratik”, “Paqja e përgjakshme”, “Shpërngulja e shqiptarëve”, “Demokracia e shpërdorur”, “Ideologjia e shpërbërjes”, “Realiteti i shpërfillur”, “Rilindja e dytë” etj., Qosja na shfaqet si një mendimtar origjinal në lidhje me një numër idesh dhe fenomenesh politike dhe shoqërore. Pikërisht këtë dimension të krijimtarisë së tij do ta trajtojmë në këtë punim.

2. Politika dhe morali sipas Qosjes

Politika si shkencë ka lidhje të rëndësishme me etikën. Ajo përmban gjithnjë edhe anën e saj morale. Etika politike studion mundësitë e argumentimit të principeve etike (parimeve, aksiomave), normave (ligjeve dhe rregullave) dhe virtuteve (pikëpamjeve, ideve). Profesor Qosja preferon një politikë me bazë etike, e përmbledhur në dy parime: “Parimi i parë: morali i shtetit pashmangshëm kushtëzon moralin e shoqërisë dhe, parimi i dytë, politika e moralshme historikisht është treguar më e leverdishme dhe natyrisht shumë më frytdhënëse si në përpjesëtime kombëtare ashtu edhe në përpjesëtime botërore se sa politika e pamoral.”

Duke i analizuar rrethanat e krijuara pas luftës në Kosovë, Qosja konstaton se “populli

shqiptar po “kalon një krizë të shtrirë shpirtërore dhe morale”. Ai e shpreh hapur zhgënjimin e tij për gjendjen morale të shoqërisë shqiptare: “Deri kur dija dhe ndershmëria politike do të jenë pengesë, kurse mosdija, banaliteti dhe mashtrimi - përparësi?” Kjo krizë, sipas tij, shpërfaqet në formën e “keqpërdorimit të padenjë të lirisë”. Qosja thërret për kthim tek vlerat, idetë, parimet dhe virtutet. Në këtë kontekst Qosja është shumë i ashpër ndaj mungesës së etikës te politikanët: “Është dobësuar shumë njeriu në politikën tonë dhe është dobësuar shumë njeriu në politikë në tonë. Më i shpeshtë se politikani i përgjegjshëm dhe zemërhapur është politikani i tjetërshfaqshëm e pa skrupuj. Më i shpeshtë se politikani i qëndruar, është politikani makiavelsit a i hallakatur, që vazhdimisht e sheh kanibalin para deryve dhe nxit përçarje e urrejtje në opinion.”

Rexhep Qosja në projektet e tij teorike synon ta krijojë njeriun e ri shqiptar, të bazuar në idetë e Naim Frashërit për moralin: një njeri të ditur, me karakter, të qytetëruar, i cili bashkon dijen me natyrën, mendjen me nderin, aftësinë me përgjegjësinë, që i kupton nevojat e vendit, e kuptimëson jetën dhe shoqërinë. Pra me një njeri të tillë “në të cilin janë bashkuar mendja e karakteri, cilësia mendore dhe cilësia shpirtërore, natyra dhe kultura, mund të tejkalohet kriza shpirtërore e morale.” Dhe, një njeri të tillë ideal mund ta krijojë politika, shkenca dhe arsimit përmes shtetit të së drejtës, sistemit demokratik dhe sistemit arsimor të orientuar drejt shkencës.

3. Ideja e lirisë dhe demokracisë

Krijimtarinë politikologjike të Rexhep Qosjes e përshkon mendimi i qartë për vlerat politike. Ai angazhohet për liri, barazi, demokraci dhe vetëvendosje si parime themelore të humanizmit njerëzor. Ai nuk beson në demokraci pa liri, as në barazi pa demokraci. Barazia e popujve nuk realizohet përmes diktateve të popujve të tjerë. Aty ku synohet të vendoset demokracia përmes gjendjes së jashtëzakonshme, aty nuk ka as liri dhe as demokraci: “Demokracia nënkupton lirinë dhe barazinë e popujve dhe të njerëzve. Pa barazi të popujve në bashkësinë shumëkombëshe, nuk mund të flitet për barazi të qytetarëve.”

Konceptet etike dhe filozofike të Rexhep Qosjes kanë natyrë humane. Ai nuk është një nacionalist i ashpër, siç është portretizuar shpesh në mediet serbe, por një humanist i bindur. Ai fton për sjellje racionale, etike dhe të përgjegjshme në raport

me individin tjetër. Edhe bashkësia njerëzore mund të ekzistojë vetëm në saje të përgjegjësisë që ndan njeriu për njeriun dhe populli për popullin. Kombëtares Qosja e sheh vetëm si një mundësi për të shprehur botëroren, universalen, për të krijuar parakushtet për zhvillimin e lirë të individit dhe kombit.

Janë me dhjetëra artikuj dhe punime tjera në të cilat ai e trajton vlerën e lirisë. Liria për të “është kuptimi i jetës së njeriut. Por, siç është provuar shumë herë gjatë historisë, sidomos gjatë shekullit të kaluar, liria në varfëri, në pushtime dhe në diktaturë nuk e kuptimëson jetën e njeriut. Liria është vërtetë liri vetëm në demokraci”. Sipas tij njeriu ka lindur për të qenë i lirë. Ai është i bindur se të gjitha pushtet që këtë të drejtë natyrore të njeriut “e gulçojnë, e cenojnë, e kufizojnë me dhunë pashmangshëm do të vdesin prej dhunës”. Ideja e lirisë është motori shtytës i lëvizjes drejt historisë.

Kur po ushtrohej trysni e madhe ndaj shkrimtarëve shqiptarë për t’u bërë pjesë e instrumentalizimit politik në procesin e shtypjes së të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi, Rexhep Qosja ishte i pari shkrimtar shqiptar që hapur, në Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë, në vitin 1985, do të fliste për mungesën e lirisë në Kosovë, do të mbronte gjuhën shqipe, identitetin kombëtar shqiptar dhe do të demaskonte dhunën që ushtronte shteti jugosllav ndaj shqiptarëve. Ai do të deklaronte: “Do të flas në gjuhën serbokroate, jo që të mos më quaj kush shkrimtar “autoqefal”, sepse besoj se gjuhë autoqefale s’ka në këtë botë dhe jo që të më dhurohet ndonjë duartrokitje, se e di përpara, duartrokitje për këtë diskutim nuk mund të pres, por që të më marrin vesh të gjithë. Do të flas si intelektual shqiptar, e të jesh intelektual shqiptar - shkrimtar a shkencëtar - shqiptar domethënë të jesh, pors personazhi i Franc Kafkës, Jozef K., njeri që vazhdimisht pret ta thërrasin. Do të flas si intelektual shqiptar, e të jesh intelektual shqiptar sot, më në fund, domethënë: të jesh çka nuk je e të mos jesh çka je.”

Pas fjalimit të tij në Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë do të fillonte një tiradë akuzash kundër tij. Këtij presioni kundër lirisë së tij individuale dhe kundër lirisë së popullit shqiptar, Qosja do t’i përgjigjej para shkrimtarëve jugosllavë: “Detyrë morale e shkrimtarit nuk është që të flasë siç i pëlqen dikujt, por siç është e vërteta. Unë jam këtu në parlamentin e mendjes - që të them të vërtetën, e jo në kishë - që të rrëfhem”. Në këtë fjali, në fakt, përmbledhet e gjithë esenca e etikës politike të Rexhep Qosjes.

Për të realizuar idenë e lirisë

Rexhep Qosja nuk e përjashton edhe përdorimin e luftës. Pra, ai është humanist, por jo pacifist. Një popull mund të pësojë disfatë në luftë, por ai është më mirë të humb duke zhvilluar betejën, se sa pa hyrë fare në betejë. Prandaj, lindja e UÇK-së e gëzon fort profesorin. Në të ai e sheh mundësinë për të realizuar lirinë. Ajo është subjekti që e sfidon Serbinë. UÇK është për Qosjen “ushtria e popullit: ajo është e pazhdukshme, ajo pavarësisht prej disfatave që në çaste të caktuara do të mund të pësojë, do të ringjallet prej hirit të vet - si Feniksi.” Ai e adhuron krenarinë, qëndresën, vendosmërinë, qëllimet liridashëse dhe gatishmërinë për flijim të luftëtarëve tanë. Ishin këta ushtarë lirie që i dhanë shtytje zhvillimit të historisë në drejtimin e duhur: në shpërbërjen përfundimtare të burgut të popujve të quajtur Jugosllavi.

4. Ideja e bashkimit kombëtar

Profesor Qosja e fillon librin e tij “Strategjia e bashkimit shqiptar” me një konstatim interesant: “Gjeografia e ka bashkuar popullin shqiptar me Evropën, por historia shumë kohë e ka ndarë prej saj. Megjithatë për nga pozita gjeografike është Evropë, për nga historia ai ishte gjatë i detyruar të jetë Azi.” Ky fakt ka bërë që shqiptarët të perceptohen në mënyrë të njëanshme edhe nga Lindja edhe nga Perëndimi. Për Lindjen ata janë më shumë perëndimorë se sa lindorë, kurse, për perëndimin, shqiptarët janë më shumë lindorë se sa perëndimor. Ky kontekst paragjykes ka sjellë edhe momente tragjike në historinë shqiptare.

Si duhet të sillen shqiptarët në këtë kontekst gjeostrategjik dhe kulturo-historik? Qosja mendon se duhet të sillen të tillë siç janë, pa u munduar të dëshmojnë më perëndimorë se perëndimorët, por edhe pa pasur drojë nga elementet e trashëguara religjioze dhe kulturore nga lindja. E rëndësishme për të është që ata të maksimalizojnë fuqinë e tyre politike, ekonomike dhe kulturore: të bashkohen në një shtet.

Në fakt Rexhep Qosja në rrafshin ideor ka diçka të përbashkët me ish kancelarin Helmut Kohl. Të dy i lidh ideja e bashkimit. Më 28 nëntor 1989 kancelari gjerman Helmut Kohl pati paraqitur Programin 10-Pikësh për Bashkimin e Gjermanisë para Bundestagut Gjerman. Me këtë Plan kancelari gjerman nuk i befasoi vetëm opozitën dhe miqtë e tij ndërkombëtar, por edhe shumë nga anëtarët e partisë së tij. Në fjalën e tij para Bundestagut ai pati thënë: “Rruga drejt bashkimit nuk është shtruar në tavolinën e gjelbër ose përmes planifikimit

'Elektroseveri' licencohet për furnizimin e veriut me rrymë

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE) ka miratuar të premten licencën për kompaninë "Elektroseveri" për furnizimin e veriut e Kosovës me energji elektrike. Bordi i ZRRE-së votoi me pesë vota për dhe asnjë kundër. "Elektroseveri" është në pronësi të kompanisë energjetike të Serbisë, EPS (Elektroprivreda Srbije), por në Kosovë është themeluar me ligje të Kosovës. Kjo kompani do ta bëjë edhe furnizimin, edhe faturimin e rrymës së shpenzuar në veri. Licencimi i saj është paraparë me një marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë për energjinë, e cila është arritur në vitin 2013, por pajtimi për zbatimin e saj është bërë më 21 qershor. Me këtë marrëveshje është paraparë që konsumatorët në veri ta paguajnë vetë rrymën e

shpenzuar. Nga fundi i luftës, më 1999, deri më 2017, rrymën për ta e kanë paguar qytetarë të pjesëve të tjera të Kosovës. Nga 2017-ta e këndej, për shkak të ankesave të shumta, përgjegjësia për pagesën ka kaluar te Qeveria e Kosovës. Veriu, i banuar me shumicë serbe, ka refuzuar pagesën për shkak të mosbindjes qytetare, por edhe ndikimit të strukturave të ndryshme atje që kanë operuar me dirigjimin e Serbisë. Kryesuesi i Bordit të ZRRE-se, Ymer Fejzullahu, ka thënë të premten se qytetarët e katër komunave në veri - Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zvečan - do të faturohen me çmimet që i ofron kompania furnizuese "Elektroseveri". Përndryshe, ZRRE-ja miraton çdo vit tarifën për operatorët e tjerë energjetikë.



Kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, ka deklaruar më 21 qershor se "Elektroseveri" nuk do të prodhojë rrymë, por do

ta blejë atë qoftë nga Korporata Energjetike e Kosovës apo nga një tjetër ofertues në tregun ndërkombëtar,

inkasimin do ta bëjë vetë. "Elektroseveri", rrjedhimisht, mund të marrë apo blejë rrymë edhe nga kompania serbe EPS.



Policia parandalon kontrabandim të pemëve, perimeve dhe drurëve

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Policia e Kosovës, respektivisht njësitë policore nga Drejtoria Rajonale Kufitare - Veriu, në tri raste të ndryshme kanë ndaluar tre kamionë të ngarkuar me mallra pa dokumente përcjellëse. "Me datë 23.06.2022, rreth orës 16:00, në vazhden e aktiviteteve për parandalimin e kontrabandës, Policia e Kosovës, bazuar në analizën e informacioneve të pranuar, ka ndaluar një kamion me targa të huaja që po lëvizte nga territori i Kosovës në drejtim të Serbisë me vozitës dhe pasagjerë meshkuj shtetas të Serbisë, në të cilin kishin të ngarkuar pemë, perime dhe shkrepëse rimbushëse. Po ashtu, në datën e lartcekur, rreth orës 20:00, në dy raste të ndara janë ndaluar dy kamionë: njëri me targa vendore, tjetri me targa të huaja, me vozitës meshkuj kosovarë, të ngarkuara me dru

në sasi gjithsej 34 metra kub dhe pa dokumente përcjellëse", ka njoftuar Policia e Kosovës. Lidhur me rastet për të gjitha veprimet është njoftuar prokurori kompetent, me autorizim të të cilit janë iniciuar rastet "Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare apo vijës kufitare dhe kontrabandim me mallra". Në rastin e parë automjeti dhe mallrat e dyshuara janë sekuestruar dhe dërguar në terminalin Doganor në Mitrovicë dhe me vendim të prokurorit lënda trajtohet në procedurë të shpejtë dhe të dyshuarit dërgohen në mbajtje. Në dy raste të tjera është njoftuar Agjencia Pyjore e Kosovës në Mitrovicë për veprimet e mëtejshme dhe me vendim të prokurorit rasti trajtohet në procedurë të rregullt dhe të dyshuarit lirohen në procedurë të rregullt.

Publikohet rregullimi i çmimit të naftës

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka publikuar Udhëzimin Administrativ të miratuar në mbledhjen e fundit për rregullimin e çmimeve të

naftës. Sipas këtij UA, në Nenin 4 të Rregullimi i çmimeve - Marzha Tregtare, çmimi për marzhën tregtare maksimale për litër të produktit të naftës shitur me shumicë është 2

centë, kurse për litër të produktit të shitur me pakicë është 12 centë. Tregtarët e naftës me shumicë me këtë rregullim të çmimit mund ta shesin naftën me fitim

maksimal 2 centë, kurse ata me pakicë me fitim 12 centë. Ky vendim do të mbetet në fuqi për 90 ditë, përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe.



Filozofia dhe etika politike e Rexhep Qosjes



Prof. ass. dr. SABRI KIÇMARI

1. Hyrje

Duhet të ketë qenë vjeshta e vitit 1995 kur e kam parë për herë të parë akademik Rexhep Qosjen në një orë letrare. Me një mjekër të zezë e karakteristike, me trupin drejt dhe kokën lart, kur hyri në sallën e Fakultetit Filozofik, ku mbahej ora letrare, salla u elektrizua nga duartrokitje frenetike. Kishite diçka sokratiane në këtë skenë. Ai ishte bërë simboli karizmatik i dijetarit, të cilin ne, të rinjtë dhe të rejtat veprimtarë për Republikën e Kosovës, e konsideronim se është “në anën tonë, në anën e Republikës.” Diçka e tillë nuk ishte e rëndomtë në atë kohë.

Sociologu francez Pierre Bourdieu duke analizuar ambientin social në një shoqëri në mesin e katër formave të kapitalit e definoi edhe kapitalin kulturor. Ai e dallon kapitalin kulturor nga ai ekonomik, social dhe simbolik. Nuk ka asnjë personalitet në botën intelektuale shoqërore në Kosovë të jetë i pajisur me më shumë vlera etike e kulturore se sa akademik Rexhep Qosja. Në krijimin e këtij kapitali vleror, profesor Qosja është ndeshur me kundërshti, arrogancë të pushtetit, përndjekje dhe dhunë të hapur psikologjike. Rezistenca e tij ndaj të padrejtës, robërisë dhe pabarazisë e ka shndërruar atë në simbol të dinjitetit intelektual ndër shqiptarë.

Figura karizmatike e Rexhep Qosjes është krijuar nëpër decenie për të marrë karakterin e një prej personaliteteve më të shquara të botës shkencore, politike dhe shoqërore ndër shqiptarë. I lindur më 25 qershor 1936 në Vuthaj, në Krahinën e Malësisë, ku mbaroi klasën e para të fillores dhe pastaj gjysmëmatoren në Gusi, si djalë i ri u vendos fillimisht në Mitrovicë dhe pastaj në Prishtinë. Prishtina dhe Vuthaj do ta përcjellin gjatë gjithë jetës së tij si ambiente jetësore, me gjithë dallimet e mëdha të tyre. Çdo verë profesori do të shkojë në Vuthaj, për të shijuar ajrin e pastër të bjeshkëve dhe për të përjetuar dashurinë e pamasë të malësorëve, kurse në kohë pune e semestrash do të kalojë në mesin e studentëve, pedagogëve, studiuesve dhe veprimtarëve për liri.

Profesor Qosja ka shkruar disa dhjetëra libra me studime letrare, kritikë letrare, romane, tregime, drama, recensione, vështrime, trajtesa, artikuj, sprova dhe punime politikologjike. Disa nga librat e tij janë botuar në gjuhë të

ndryshme si në anglisht, gjermanisht, frëngjisht dhe gjuhë të tjera. Të njohur më së shumti e ka bërë libri i tij “Vdekja më vjen prej syve të tillë”. Ky nuk është një roman i thjeshtë. Ai është paraqitja e një tabloje të zymtë të jetës së shqiptarit në Kosovë. Në të ai përshkruan jetën e rëndë nën kontrollin policor të regjimit të Lidhjes Komuniste. Ndeshja morale në mes të Danjollit të Sherkes, si shërbëtor i pushtetit, dhe Xhezairit të Xhikës, ka karakter moral, politik dhe human. Përshkrimi i gjendjes së zymtë nën robëri, përcjellë një mesazh politik vleror për lexuesin që do të mund të përmbledhë në një thirrje për veprim: Kjo gjendje nuk durohet më! Këtë gjendje duhet ndryshuar! Sistemi diktatorial, me sytë e tij që vrasin, duhet zhbërë, duke punuar për të krijuar sistemin e lirisë individuale dhe kolektive.

Shkrimtari ynë i njohur Isamil Kadare duke ja paraqitur këtë vepër publikut francez ka shkruar: “Vdekja më vjen prej syve të tillë” është një vepër me inspirim kafkian, një roman që prish qetësinë, një vepër që profetizon apokalipsin dhe një nga veprat më të mëdha të letërsisë shqiptare.”

Por, Rexhep Qosja nuk është vetëm romancier, dramaturg dhe studiues i letërsisë. Ai është edhe një ndër politikologët tanë më të mirë. Në veprat e tij “Strategjia e bashkimit shqiptar”, “Çështja shqiptare - Historia dhe politika”, “Fjalor Demokratik”, “Paqja e përgjakshme”, “Shpërngulja e shqiptarëve”, “Demokracia e shpërdorur”, “Ideologjia e shpërbërjes”, “Realiteti i shpërfillur”, “Rilindja e dytë” etj., Qosja na shfaqet si një mendimtar origjinal në lidhje me një numër idesh dhe fenomenesh politike dhe shoqërore. Pikërisht këtë dimension të krijimtarisë së tij do ta trajtojmë në këtë punim.

2. Politika dhe morali sipas Qosjes

Politika si shkencë ka lidhje të rëndësishme me etikën. Ajo përmban gjithnjë edhe anën e saj morale. Etika politike studion mundësitë e argumentimit të principeve etike (parimeve, aksiomave), normave (ligjeve dhe rregullave) dhe virtuteve (pikëpamjeve, ideve). Profesor Qosja preferon një politikë me bazë etike, e përmbledhur në dy parime: “Parimi i parë: morali i shtetit pashmangshëm kushtëzon moralin e shoqërisë dhe, parimi i dytë, politika e moralshme historikisht është treguar më e leverdishme dhe natyrisht shumë më frytdhënëse si në përpjesëtime kombëtare ashtu edhe në përpjesëtime botërore se sa politika e pamoral.”

Duke i analizuar rrethanat e krijuara pas luftës në Kosovë, Qosja konstaton se “populli

shqiptar po “kalon një krizë të shtrirë shpirtërore dhe morale”. Ai e shpreh hapur zhgënjimin e tij për gjendjen morale të shoqërisë shqiptare: “Deri kur dija dhe ndershmëria politike do të jenë pengesë, kurse mosdija, banaliteti dhe mashtrimi - përparësi?” Kjo krizë, sipas tij, shpërfaqet në formën e “keqpërdorimit të padenjë të lirisë”. Qosja thërret për kthim tek vlerat, idetë, parimet dhe virtutet. Në këtë kontekst Qosja është shumë i ashpër ndaj mungesës së etikës te politikanët: “Është dobësuar shumë njeriu në politikën tonë dhe është dobësuar shumë njeriu në politikë në tonë. Më i shpeshtë se politikani i përgjegjshëm dhe zemërhapur është politikani i tjetërshfaqshëm e pa skrupuj. Më i shpeshtë se politikani i qëndruar, është politikani makiavelsit a i hallakatur, që vazhdimisht e sheh kanibalin para deryve dhe nxit përçarje e urrejtje në opinion.”

Rexhep Qosja në projektet e tij teorike synon ta krijojë njeriun e ri shqiptar, të bazuar në idetë e Naim Frashërit për moralin: një njeri të ditur, me karakter, të qytetëruar, i cili bashkon dijen me natyrën, mendjen me nderin, aftësinë me përgjegjësinë, që i kupton nevojat e vendit, e kuptimëson jetën dhe shoqërinë. Pra me një njeri të tillë “në të cilin janë bashkuar mendja e karakteri, cilësia mendore dhe cilësia shpirtërore, natyra dhe kultura, mund të tejkalohet kriza shpirtërore e morale.” Dhe, një njeri të tillë ideal mund ta krijojë politika, shkenca dhe arsimit përmes shtetit të së drejtës, sistemit demokratik dhe sistemit arsimor të orientuar drejt shkencës.

3. Ideja e lirisë dhe demokracisë

Krijimtarinë politikologjike të Rexhep Qosjes e përshkon mendimi i qartë për vlerat politike. Ai angazhohet për liri, barazi, demokraci dhe vetëvendosje si parime themelore të humanizmit njerëzor. Ai nuk beson në demokraci pa liri, as në barazi pa demokraci. Barazia e popujve nuk realizohet përmes diktateve të popujve të tjerë. Aty ku synohet të vendoset demokracia përmes gjendjes së jashtëzakonshme, aty nuk ka as liri dhe as demokraci: “Demokracia nënkupton lirinë dhe barazinë e popujve dhe të njerëzve. Pa barazi të popujve në bashkësinë shumëkombëshe, nuk mund të flitet për barazi të qytetarëve.”

Konceptet etike dhe filozofike të Rexhep Qosjes kanë natyrë humane. Ai nuk është një nacionalist i ashpër, siç është portretizuar shpesh në mediet serbe, por një humanist i bindur. Ai fton për sjellje racionale, etike dhe të përgjegjshme në raport

me individin tjetër. Edhe bashkësia njerëzore mund të ekzistojë vetëm në saje të përgjegjësisë që ndan njeriu për njeriun dhe populli për popullin. Kombëtarën Qosja e sheh vetëm si një mundësi për të shprehur botëroren, universalen, për të krijuar parakushtet për zhvillimin e lirë të individit dhe kombit.

Janë me dhjetëra artikuj dhe punime tjera në të cilat ai e trajton vlerën e lirisë. Liria për të “është kuptimi i jetës së njeriut. Por, siç është provuar shumë herë gjatë historisë, sidomos gjatë shekullit të kaluar, liria në varfëri, në pushtime dhe në diktaturë nuk e kuptimëson jetën e njeriut. Liria është vërtetë liri vetëm në demokraci”. Sipas tij njeriu ka lindur për të qenë i lirë. Ai është i bindur se të gjitha pushtet që këtë të drejtë natyrore të njeriut “e gulçojnë, e cenojnë, e kufizojnë me dhunë pashmangshëm do të vdesin prej dhunës”. Ideja e lirisë është motori shtytës i lëvizjes drejt historisë.

Kur po ushtrohej trysni e madhe ndaj shkrimtarëve shqiptarë për t’u bërë pjesë e instrumentalizimit politik në procesin e shtypjes së të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi, Rexhep Qosja ishte i pari shkrimtar shqiptar që hapur, në Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë, në vitin 1985, do të fliste për mungesën e lirisë në Kosovë, do të mbronte gjuhën shqipe, identitetin kombëtar shqiptar dhe do të demaskonte dhunën që ushtronte shteti jugosllav ndaj shqiptarëve. Ai do të deklaronte: “Do të flas në gjuhën serbokroate, jo që të mos më quaj kush shkrimtar “autoqefal”, sepse besoj se gjuhë autoqefale s’ka në këtë botë dhe jo që të më dhurohet ndonjë duartrokitje, se e di përpara, duartrokitje për këtë diskutim nuk mund të pres, por që të më marrin vesh të gjithë. Do të flas si intelektual shqiptar, e të jesh intelektual shqiptar - shkrimtar a shkencëtar - shqiptar domethënë të jesh, pors personazhi i Franc Kafkës, Jozef K., njeri që vazhdimisht pret ta thërrasin. Do të flas si intelektual shqiptar, e të jesh intelektual shqiptar sot, më në fund, domethënë: të jesh çka nuk je e të mos jesh çka je.”

Pas fjalimit të tij në Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë do të fillonte një tiradë akuzash kundër tij. Këtij presioni kundër lirisë së tij individuale dhe kundër lirisë së popullit shqiptar, Qosja do t’i përgjigjej para shkrimtarëve jugosllavë: “Detyrë morale e shkrimtarit nuk është që të flasë siç i pëlqen dikujt, por siç është e vërteta. Unë jam këtu në parlamentin e mendjes - që të them të vërtetën, e jo në kishë - që të rrëfhem”. Në këtë fjali, në fakt, përmbledhet e gjithë esenca e etikës politike të Rexhep Qosjes.

Për të realizuar idenë e lirisë

Rexhep Qosja nuk e përjashton edhe përdorimin e luftës. Pra, ai është humanist, por jo pacifist. Një popull mund të pësojë disfatë në luftë, por ai është më mirë të humb duke zhvilluar betejën, se sa pa hyrë fare në betejë. Prandaj, lindja e UÇK-së e gëzon fort profesorin. Në të ai e sheh mundësinë për të realizuar lirinë. Ajo është subjekti që e sfidon Serbinë. UÇK është për Qosjen “ushtria e popullit: ajo është e pazhdukshme, ajo pavarësisht prej disfatave që në çaste të caktuara do të mund të pësojë, do të ringjallet prej hirit të vet - si Feniksi.” Ai e adhuron krenarinë, qëndresën, vendosmërinë, qëllimet liridashëse dhe gatishmërinë për flijim të luftëtarëve tanë. Ishin këta ushtarë lirie që i dhanë shtytje zhvillimit të historisë në drejtimin e duhur: në shpërbërjen përfundimtare të burgut të popujve të quajtur Jugosllavi.

4. Ideja e bashkimit kombëtar

Profesor Qosja e fillon librin e tij “Strategjia e bashkimit shqiptar” me një konstatim interesant: “Gjeografia e ka bashkuar popullin shqiptar me Evropën, por historia shumë kohë e ka ndarë prej saj. Megjithatë për nga pozita gjeografike është Evropë, për nga historia ai ishte gjatë i detyruar të jetë Azi.” Ky fakt ka bërë që shqiptarët të perceptohen në mënyrë të njëanshme edhe nga Lindja edhe nga Perëndimi. Për Lindjen ata janë më shumë perëndimorë se sa lindorë, kurse, për perëndimin, shqiptarët janë më shumë lindorë se sa perëndimor. Ky kontekst paragjykes ka sjellë edhe momente tragjike në historinë shqiptare.

Si duhet të sillen shqiptarët në këtë kontekst gjeostrategjik dhe kulturo-historik? Qosja mendon se duhet të sillen të tillë siç janë, pa u munduar të dëshmojnë më perëndimorë se perëndimorët, por edhe pa pasur drojë nga elementet e trashëguara religjioze dhe kulturore nga lindja. E rëndësishme për të është që ata të maksimalizojnë fuqinë e tyre politike, ekonomike dhe kulturore: të bashkohen në një shtet.

Në fakt Rexhep Qosja në rrafshin ideor ka diçka të përbashkët me ish kancelarin Helmut Kohl. Të dy i lidh ideja e bashkimit. Më 28 nëntor 1989 kancelari gjerman Helmut Kohl pati paraqitur Programin 10-Pikësh për Bashkimin e Gjermanisë para Bundestagut Gjerman. Me këtë Plan kancelari gjerman nuk i befasoi vetëm opozitën dhe miqtë e tij ndërkombëtar, por edhe shumë nga anëtarët e partisë së tij. Në fjalën e tij para Bundestagut ai pati thënë: “Rruga drejt bashkimit nuk është shtruar në tavolinën e gjelbër ose përmes planifikimit



me dorë të një plani terminësh... Ne mundemi, nëse vetëm duam, që sot t'i përgatisim ato etapa, të cilat sjellin deri te ky qëllim... Se si do të duket një Gjermani e ribashkuar, nuk e di sot askush. Por, që bashkimi do të vijë, nëse njerëzit në Gjermani këtë gjë e duan, për këtë jam i sigurt".

Ndryshe nga Helmut Kohli, Qosja ishte vetëm në një fazë të shkurtër kohore aktiv politikisht. Por, struktura teorike dhe argumentuese e Rexhep Qosjes në librin e tij "Strategjia e bashkimit shqiptar" është në të njëjtën linjë me Programin e Helmut Kohlit për bashkimin e Gjermanisë. Në këtë kuadër ai e sheh zgjidhjen e çështjes shqiptare në Evropën e popujve të bashkuar: "Çështja e shqiptarëve mund të zgjidhet në mënyrë të tërësishme e jo të pjesshme, të përhershme dhe jo të përkohshme, në Evropën e popujve të bashkuar, sepse në Evropën e popujve ata, si popull i ndarë, do të bëheshin të bashkuar."

Akuzave se bashkimi i Kosovës me Shqipërinë do të krijonte Shqipërinë e Madhe, Qosja i përgjigjet me një argument të fort polemik e logjik: "Rusia me mbi 17 milionë e 75 400 km² dhe me rreth 150 milionë banorë nuk quhet Rusi e Madhe; as Gjermania e bashkuar me 357 mijë km² dhe me rreth 80 milionë banorë nuk quhet Gjermani e Madhe, as Kina me 9 milionë e 551 mijë km² dhe me rreth 1 miliardë e 200 milionë njerëz nuk quhet Kinë e Madhe, ndërsa Shqipëria e Bashkuar, e përbërë prej Shqipërisë së sotme dhe prej tokave

shqiptare në ish Jugosllavi që kanë vazhdimësi gjeografike me të dhe në të cilat shqiptarët janë popullatë e vetme apo shumicë e madhe, që do të kishte gjithsej 55 mijë km² dhe rreth 7 milionë banorë do të quhej Shqipëri e Madhe! Jo. Shqipëria e bashkuar, e përbërë prej dy gjysmave të popullit të ndarë shqiptarë, nuk mund të quhet Shqipëri e Madhe: ajo do të ishte Shqipëria natyrore."

Qosja është i qartë në dallimin në mes të identitetit shtetëror dhe atij kombëtar. Identiteti kombëtar kosovar, i tillë siç propagandohet si identiteti i ri, i ngjan shumë idesë për identitetin kombëtar jugosllav ose identitetin kombëtar sovjetik. Bazë e një logjike të tillë është sentenca se shteti përcakton identitetin kombëtar, përkatësisht se shteti e krijon kombin dhe jo kombi shtetin. Natyrisht që në këtë rast kemi të bëjmë me një ngatërrim të identitetit shtetëror me identitetin kombëtar. Sipas Qosjes qëllimi i krijesve të kësaj ideje është krijimi i një ideologjie "kundër konceptit një popull, një kulturë, një gjuhë letrare, një komb". Ai e quan këtë një "ideologji kundër historike me të cilën do të mposhtej përgjithmonë ideja që e ka lëvizur historinë e popullit shqiptar prej Lidhjes së Prizrenit e këndeje: ideja e bashkimit kombëtar".

Njësoj si Kohli, edhe Qosja zgjidhjen e tij e bazon në të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje. Dhe, Rexhep Qosja i ka mbetur besnik pikëpamjes së tij deri në fund. E përsëriti këtë gjë edhe në

fjalën e tij në Akademinë kushtuar 85-Vjetorit të Lindjes së tij, më 25 qershor 2021, në Prishtinë: "Sot ne jemi komb me dy shtete që pashmangshëm do të bashkohen një ditë. Atë ditë mund të mos ta dimë sot, por e dimë sigurt se do të bashkohen një ditë jo edhe shumë të largët".

5. Praktika politike

Si shumica e intelektualëve në Kosovë, edhe Rexhep Qosja ka qenë i angazhuar politikisht. Por, ai nuk ka pasur asnjë rol drejtues partiak gjatë sundimit të sistemit njëpartiak të Lidhjes Komuniste të Kosovës, përkatësisht Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë. Në kuadër të procesit të diferencimit ideopolitik atij i jepet vërejtje partiake për shkak të mosdënimit të demonstratave studentore të vitit 1981.

Pas gjysmës së viteve 1980 Rexhep Qosja shndërrohet në një lloj institucioni më vete politik: simpatizohet deri në adhurim nga të rinjtë veprimtarë të idesë së Republikës së Kosovës dhe urrehet deri në kërcënim nga aktivistët e Lidhjes Komuniste të Kosovës. I reduktohet publikimi dhe stigmatizohet politikisht vepra e tij letrare. Më 30 maj 1989 Rexhep Qosja mban takim me delegacionin e Parlamentit Evropian. Takimi zhvillohet në dhomë të hotelit. Atë ditë Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës organizoi demonstrata në Llap dhe Prishtinë. Në Llap u vra Ali Ajeti gjatë përleshjes me

policinë. Qosja argumenton fuqishëm kundër dhunës që ushtrohet ndaj demonstruesve dhe kundër sistemit të shtypjes që sundonte në Kosovë. Si rezultat Parlamenti Evropian përmes një Rezolutive e dënoi dhunën kundër shqiptarëve në Kosovë.

Gjatë vitit 1998 Qosja, më në fund, vendos të angazhohet politikisht duke marrë drejtimin e Lëvizjes së Bashkuar Demokratike. Si kryetar partie merr pjesë në Konferencën e Rambujesë. Ai insiston që në Rambuje të mos shkohet pa përfaqësuesit e UÇK-së. Ishte i bindur se ushtarët e UÇK-së e kanë sjell Kosovën në Rambuje: "Kosova ishte në gjunjë dhe ata e ngritën në këmbë. Ne ishim të përkulur, tepër të përkulur, e ata na drejtuan. Na shikonim përtokë, e ata na e kthyen nderin dhe dinjitetin. Ne ishim objekt në politikë, e ata, me vetëflijmë të tyre, me luftën e tyre, na bënë subjekt." Ai luan rol parësor në përafrimin e delegacionit të Kosovës dhe në mandatimin drejtues të delegacionit. Ai ndikon që të ketë sjellje racionale dhe politikisht korrekte.

Nga Rambuje Qosja na ka sjellë një material me vlerë për diplomacinë dhe artin e negociimit përmes shënimeve të tij të mbajtura gjatë Konferencës së Rambujesë, të botuar në formë libri me titullin "Paqja e përgjakshme". Në këtë ditar ai mban shënime për takimet, bisedimet dhe përjetimet e tij gjatë Konferencës së Rambujesë. Ai mbron pikëpamjen se Marrëveshja e nënshkruar prej tij dhe anëtarëve të tjerë të

delegacionit të Kosovës në Rambuje ka pasur rol të dyfishtë, historik dhe tragjik, njëkohësisht: ajo është Marrëveshje që e ka çelur derën e lirisë, por e ka çelur edhe derën e tragjedisë. Dhe: "Paqja që do të sjellë ajo Marrëveshje paqësore do të jetë paqe e përgjakshme".

Me udhëheqësit e procesit negociatar argumenton bindshëm dhe racionalisht. Ai insiston në të drejtën për vetëvendosje përmes referendumit: "Referendumi është institucion demokratik, i krijuar në filozofinë politike të Perëndimit për zgjidhjen e çështjeve siç është e jona. Argumentet teorike dhe praktike e mbështesin të drejtën tonë për referendum". Përgjatë zhvillimit të Konferencës së Rambujesë, persiatjet filozofike, politike dhe etike të Qosjes janë tepër racionale, në një kohë iracionale. Ai shkruan se në Rambuje kanë shkruar të sjellin paqe për Kosovën, por jo paqe pa liri. Në këtë kontekst, më 11 shkurt 1999, i deklaroi Ministrin të Jashtëm Britanik Robin Cook: "Ne kemi ardhur këtu me dëshirën dhe me shpresën që Kosovës t'ia çojmë paqen. Paqja i duhet Kosovës më shumë se çdo gjë tjetër. Por, çfarë paqeje? Që të jetë e qëndruar, e përhershme, paqja duhet të jetë e drejtë. Kosovës i duhet, pra, paqe e drejtë".

6. Për demonstratat e vitit 1981

Qosja bën pjesë në mesin e intelektualëve në Kosovë që nuk i kanë dënuar

demonstratat e vitit 1981. Për këtë ai i nënshtrohet një presioni të madh politik përgjatë procesit të diferencimit ideopolitik që udhëhiqej nga Lidhja Komuniste e Kosovës. Qosja zgjedh heshtjen si mënyrë të reagimit të tij ndaj trysnisë së Lidhjes së Komunistëve. Ai mbrohet me heshtje. Dhe, heshtja e tij flet. Vite më vonë ai shkruan: "Ekzistojnë filozofia dhe estetika e fjalës së shkruar dhe e fjalës së folur, por ekzistojnë edhe filozofia dhe estetika e fjalës së heshtur dhe e mendimit të heshtur".

Në gjysmën e dytë të viteve 1980 profesor Qosja shkruan se udhëheqjet politike të pas vitit 1981 kanë rënë në provimin politik historik. Ata i kanë pranuar formulat kundërshtqiptare edhe pse nuk kanë besuar në to. Pra, i kanë bërë dëm popullit të tyre, për hir të karrierës së tyre. Me këtë rast ata janë gjendur të izoluar nga populli. Kanë filluar të konsiderohen si kolaboracionistë: "Për të qenë tragjedia morale e këtyre udhëheqjeve edhe më e madhe, ata jo vetëm se ashtu janë izoluar plotësisht prej popullit, kur e kur duke u vënë edhe kundër popullit, por njëkohësisht, janë përpjekur ta detyrojnë edhe popullin që të flasë e të veprojë kundër vetes. Kjo ishte vetëvrasje politike dhe morale e udhëheqjeve tona politike."

7. Apostulli i lirisë

Rexhep Qosja i ka kritikuar shumë të tjerët. Kjo natyrisht i

ka kushtuar jo pak shqetësime në jetën e tij krijuese, politike dhe shoqërore. "Morfologjia e një fushate" paraqet vetëm fillimin e një numri të madh polemikash e kritikash të tij drejtuar personaliteteve politike, shoqërore, kulturore dhe krijuese. Por, Rexhep Qosja ka ditur edhe të veçojë personalitete të çmuara të historisë, letërsisë dhe kulturës sonë kombëtare. Një nga shkrimet me të çmuara politikologjike të tij është Fjala e tij në shënimin e 60-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit. Edhe varianti më i zgjeruar i kësaj fjale, botuar në veprën e dhjetë të kompletit të veprave të Adem Demaçit në formën e pasthënies, përmban një fjali që përmbledh rolin e veprimtarisë së Adem Demaçit: "Para vetes dhe para botës ne ende nuk kemi mundësi të dalim e të mburremi as me dëshmi të zhvillimit teknik, as me dëshmi të zhvillimit ekonomik. Para vetes dhe para botës sot mund të dalim e të mburremi, para së gjithash, me qëndresën madhështore politike e morale të Adem Demaçit. E, kjo ishte vepër që lëvizte ndërgjegjen tonë dhe, duke lëvizur ndërgjegjen, e lëvizte historinë".

Adem Demaçin Qosja e portretizon si apostull të lirisë, drejtësisë shoqërore dhe pavarësisë së popullit të vet. Në kohën kur i drejton këto fjale, më 26.02.1996, vendi vuante keq nën thundrën e pushtuesit. Jeta e Demaçit është përshkuar nga

gatishmëria e tij për vetëmohim. Sipas Qosjes në rast se Demaçi nuk do të karakterizohej me një shkallë të lartë altruizmi, ai do të ishte "një krijues i madh i letërsisë shqipe." Pra, do të kishim një krijues të madh letrar, por nuk do të kishim një simbol kombëtar, i cili e flijoi veten për lirinë, ardhmërinë dhe dinjitetin e kombit të tij: "Letërsia shqipe do të mbesë pa një krijues të dalluar, por historia shqiptare do të fitojë një apostull të madh të lirisë". Qosja e përshkruan Demaçin si njeri me ideal të lartë por edhe me iluzionin se Kosova mund të çlirohet nga Serbia. Iluzioni nuk e ul rëndësinë historike të idealit të Adem Demaçit. Duke qenë intelektual që e kupton saktë politikën dhe historinë Demaçi sheh përtej së tashmes. Jetëshkrimi i Adem Demaçit është jetë - porosi prej së cilës inteligjencia shqiptare mund të nxjerrë mësim të vlefshme morale.

8. Debati me Kadarenë

Rexhep Qosja ka zhvilluar polemika të ashpra me një numër personalitetesh letrare, politike dhe publicistike. Ai mospajtimin e definon si "tharmin e demokracisë", kurse polemikën si "kushtin e lirisë". Sipas Qosjes "polemika, liria dhe krijimtaria janë në raporte të ndërsjella dialektike. Prej natyrës së raporteve të tyre varet edhe fuqia e së vërtetës." Pra, qëllimi i polemikës është të ndahet e vërteta nga

gënjeshtra, e sakta nga e pasakta, e mira nga e keqja, e drejta nga e padrejta, e bukura nga e shëmtuara, përparimtarja prej prapambetjes. Polemika është nxitje e veprimit shpirtëror, e cila i vë në lëvizje imagjinatën, intuitën dhe ndjenjat e njeriut. Një nga debatet e tij tematike dhe shumë interesante është debati me shkrimtarin tonë Ismail Kadare. Debati ka vlerë të rëndësishme sociologjike, politikologjike dhe filozofike, pasi që fokusohet në identitetin kombëtar të shqiptarëve.

Debati fillon me shkrimin e Kadaresë "Identiteti evropian i shqiptarëve." Ky shkrim ishte një lloj replike me tezat e mbrojtura nga Qosja në shkrimin e tij "Ideologjia e shpërbërjes." Qosja i përgjigjet Kadaresë me shkrimet e tij "Idetë raciste të Kadaresë" dhe "Realiteti i shpërfillur." Ndryshe nga Kadareja, Rexhep Qosja mbron pikëpamjen se identiteti kombëtar shqiptar ndërthet në vete të dy qytetërimet: atë perëndimor dhe lindor. Kadareja shkruan se "një identitet i ndarë është një komb i ndarë." Ai shfaqë drojën se "përgjashtimi i gjysmës ose shumicës së kombit shqiptar nga identiteti evropian, do të thotë përgjashtim nga Evropa. Dhe përgjashtimi nga Evropa nuk është larg dëbimit nga Evropa".

Në përgjigjet e tij Qosja tregohet mjaft i ashpër. Ai e akuzon Kadarenë se po dëshiron të mohojë identitetin mysliman të shqiptarëve, se ai

e përbuzë ndikimin e fesë. Fetë, sipas tij, janë "përbërës shumë i rëndësishëm i identitetit". Ai e vë në fokus faktin se jeta e individit përshkohet nga një multidimensionalitet identitesh, por të gjitha këto identitete të veçanta "bashkohen në atë të përgjithshmen, të tërën, që i themi identiteti kombëtar shqiptar."

9. Përfundim

Rexhep Qosja thërret me zë për rikthim drejt vlerave etike. Ai e orienton ndaj veprimtarëve, intelektualëve dhe qytetarëve. Dhe këtë gjë e bënë në një mënyrë tepër të rrallë: "Në Greqinë e lashtë, në kohën e Homerit, rreth zjarrit të ndezur në nderim të heroit të rënë në luftë, ecnin shokët, miqtë dhe adhuruesit e tij, duke hedhur në zjarr të gjitha ato që i donin më së shumti: kush kalin, kush robin e kush vetveten. Nuk po kërkoj aq shumë prej shokëve e miqve të Fehmi Lladrovci. Nuk po kërkoj aq shumë prej nesh. Mos të hedhim në zjarr asnjë nga ato që duam. Por, le të hedhim në zjarr të këqijat tona të sotme. E, kemi çka të hedhim. Korrupsionin! Krimin e organizuar! Nepotizmin! Luksin! Privilegjet e zyrtarëve!". Veprimtari, intelektual dhe qytetari vetëm do të duhej të aprovoj një mesazh të tillë. Për hir të së sotmes dhe sidomos të ardhmes së kombit tonë!



PROF. DR. EQREM ZENELAJ, ATDHETARI DHE AKADEMIKU ME PËRMASA NDËRKOMBËTARE QË MBAN TITULLIN "KALORËS I URDHËRIT TË SKËNDERBEUT"

Njerëzit e mëdhenj nuk lindin të mëdhenj, por bëhen të mëdhenj



Major Mark Zef MARKU

Njerëzit gjatë jetës kanë dy lloj njohje, empirike dhe njohje reale. Aktualisht unë nuk kam njohje reale me prof. dr. Eqrem Zenelaj, po natyrisht kam njohje empirike për personalitetin e tij, madje edhe pse kam lexuar për aktivitetin e tij, si një intelektual e personalitetin e shquar, një atdhetar dhe historian me një përgatitje, që sa kam lexuar rreth personalitetit të tij, befasues krahasuar me shumë të tjerë që njoh, dhe një njeri i pa lodhur në 22 vite hulumtime, madje me buxhetin e familjes së tij ka përbulluar gjithçka, vërtet njeri i rrallë ndër shqiptarë.

E di edhe pse kam njohje empirike si e cilësova, me dukët që kam shumë pak dije rreth aktivitetit të tij si studiues, historian, diplomat, si atdhetar. Ashtu si ai vet e ka pohuar, deri tash ka 11 vepra të botuara, ky personalitet mbetet i veçantë ndër shqiptarë, pasi ato 11 veprat e tij sot janë pronë e Bibliotekës Kombëtare të Vjenës.

Prof. dr. Eqrem Zenelaj ka marrë mbi vete një mision shkencor historik e kombëtar për zbulimin e dokumenteve dhe ndodhitë faktike të historisë kombëtare dhe publikimin e tyre në libra, punime shkencore, revista dhe facebook, që si i cilëson ai për sa ka hulumtuar e parë, ka mjaft shtrembërime në të shkruar të historisë shqiptare deri tani, ata që kanë shkruar kanë shtrembëruar me dashje të vërtetat që gjenden në dokumentin në arkivat evropiane. Prof. Dr. Eqrem Zenelaj është sot figurë e njohur në historiografi dhe diplomaci me përmasa ndërkombëtare. Ai përveç gradave shkencore, mban titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut", dhënë nga Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta. Në veprat e tij ashtu si i bëjnë analizë profesor të huaj të cilët janë recensentë të veprave të tij, ai sjellë fakte historike të padëgjua më parë dhe të dokumentuara, e kjo përbën një risi për historinë e kombit shqiptarë. Njeriu e bëjnë të lumtur madhështia shpirtërore dhe pasuria mendore, ndaj ai vërtet ndjehet i lumtur që vendosi një gur themeli në vërtetësinë e historisë së kombit shqiptarë. Zenelaj është njeri dhe atdhetar i madh. Njerëzit e mëdhenj nuk lindin të mëdhenj,

por bëhen të mëdhenj, ai me përgatitjen e tij në disa fakultete, me dy doktorata, me titullin profesor, dhe me aktivitetin e madh hulumtues e studiues, ku ka nxjerrë mbi 5000 dokumente në 20 arkiva evropiane e më gjerë, me 11 veprat e botuara, por ky aktivitet i punës së tij e bën atë njeri të madh.

"Historia e vërtetë e njerëzimit do të shkruhet vetëm atëherë kur shqiptarët të marrin pjesë në shkrimin e saj", ka thënë Maksimilian Lambertz. Mendoj se në vlerësimin tim angazhimi maksimal dhe puna e tij e deritanishme është shumë frytdhënëse në shkrimin e drejtë të historisë shqiptare. Duke ju referuar Gazetës Shqiptare të datës 8.11.2012 gjatë një interviste Prof. Dr. Eqrem Zenelaj do të shprehej: "Unë nuk kam hulumtuar për vetën time, por për kombin shqiptar, për historinë tonë të vërtetë, si dhe jam shumë krenarë që kam shumë dokumente interesante të figurave kombëtare dhe fëmijëve fisnike shqiptare, të ngjarjeve e figurave tona që nderuan Shqipërinë dhe ngritën emrin e saj lart".

Secili nga ju, që lexon në këtë faqe, ka mundësinë që të njihet me beg raundin e pasur të një atdhetari, intelektualit e personaliteti, shkencëtari i shquar shqiptar si Prof. Dr. Eqrem Zenelaj, i cili jo vetëm nuk ndalet në thellimin e dijeve shkencore por as në hulumtimet e tij në arkivat evropiane, por ai shpesh vjen edhe në Shqipëri për të hulumtuar në vende e zona që mbartin histori të hershme, e kësaj para pak javësh ka qenë edhe në zonën e Vaut të Dejës tek Kisha e shkatërruar me dinamit me 1967 nga sistemi i shkuar ku është pritur nga Dom Kastrioti, në Kabash nga ku ka edhe vendlindjen e të parëve të tij, ku vizitoj kishën me të vjetër të Shën Palit, në Fushë Arrëz u njohë nga afër me punën e bërë për ngritjen e Memorialit kushtuar Qeverisë së parë shqiptare në Kimzës, gjithashtu vizitoj edhe Iballën, e rrethit të Pukës. Ne sigurisht që më vonë do të njihemi me misionin e tij dhe interesin e shprehur për hulumtimet në këto zona, ku ai siguri ka hulumtuar në arkivat e Evropës. Në këto vendndalesa të tij ai këmbyer mendime nga afër me studiuesin Ing. Kol Dedaj, studiuesin Mark Bardhoshi, intelektualët banorë në këto vende, zotërinjtë Ylli Hadroj dhe Demir Hyseni, ku ka shkëmbyer mendime për ngjarje e zhvillime historike në hershmëri në këto vendndalime.

Gjithashtu është njohur edhe me atdhetar si z. Dod Luli, mirditas, i cili vite me parë ka botuar dhe është autor i librit "Dera e Përnocajve Fanë" në Mirditë.



Dajat e tij Përnocajt, janë familje dëshmorësh me 1870 kundër rusëve, me 1914 kundër Princ Vidit dhe kundër regjimit komunist në Shqipëri në vitin 1948, të dëgjuar e me emër jo vetëm në Fanë të Mirditës por edhe në Amerikë. z. Dod Luli me ndjenjën e tij atdhetare dhe humane vite më parë ka bërë të mundur me shpenzimet krejtësisht të tij "Ngritjen" e Memorialit të Qeverisë së Kimzës në vitin 1911 të kryesuar nga Atdhetari Torenc Toçi. Unë kisha fatin të ndjek nga afër këtë event ditën e vendosjes së Memorialit në Fushë Arrëz. Prof. Dr. Eqrem Zenelaj në lidhje me krijimin e qeverise se Kimzës dhe memorialin në kujtim të kësaj ngjarje historike me përmasa kombëtare në këtë faqe është prononcuar me vlerësimin dhe mendimet e tij.

Prof. Dr. Eqrem Zenelaj është anëtar i Institutit të Evropës së Mesme me seli në Vjenë, i Institutit Albanologjik në Prishtinë, i Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë. Gjithashtu është pjesë e shumë simpoziumeve shkencore me karakter kombëtar e ndërkombëtar. Sot vepra e tij është cilësuar një Akademi më vete nga shumë studiues të njohur nisur nga vëllimi botimeve të tij, por edhe nga faktet e renditura me dokumente në veprat e botuara. Prof. Dr. Eqrem Zenelaj ndonëse ne si intelektual të këtij vendi shkruajmë dhe ndoshta nuk përbën problem për ata që duhet të lexojnë, këto që shkruajmë, por do vlerësoja që Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës duhet që ta

kenë pjesë të tyre atdhetarin dhe një ndër hulumtuesit më të mirë shqiptar i tanishëm, asetin me një potencial të tillë intelektual në disa fusha ashtu si është i nderuari Prof. Dr. Eqrem Zenelaj, njeriun jo vetëm i suksesit por edhe të vlerave.

Profesori Zenelaj gjatë këtij itinerari nga Tirana në këto vende e kthim është përcjell nga zotërinjtë, studiuesi Kol Dedaj dhe atdhetari Dod Luli.

Unë i uroj shëndet dhe suksese në realizimin e misionit të tij në hulumtimin dhe nxjerrjen në dritë të fakteve historike të zhvillimit të Kombit Shqiptarë.

*Me respekt
Intelektual i Pavarur dhe
Veprimtar Shoqëror
Ushtarak i Lartë në rezervë.
Mark Zef Marku
Tiranë 15.06.2022*

Lufta e re e ideve në Evropë



Nga Joschka FISCHER
"Project Syndicate"

Lufta e Rusisë në Ukrainë do ta ndajë sërish Evropën. Lindja do të ndahet nga Perëndimi, dhe kufiri mes tyre ka të ngjarë të jetë një zonë e rrezikshme, e mbikëqyrrur ushtarakisht për të ardhmen e parashikueshme. Natyrisht, ne nuk e dimë se si dhe kur do të përfundojë lufta. Por pas zhvillimeve të fundit, duket e sigurt të supozohet se si Ukraina dhe Moldavia do të bëhen kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, dhe më pas anëtarë më të drejta të plota brenda pak vitesh. Udhëheqësit e tre vendeve anëtare më të mëdha të BE-së (Franca, Gjermania dhe Italia) dhe të Rumanisë, e bënë të qartë këtë kur vizituan Kievin javën e kaluar. Ata ofruan mbështetje të plotë për anëtarësimin e Ukrainës dhe Moldavisë në union, siç bëriedhe Komisioni Evropian një ditë më vonë. Ky proces i zgjerimit, do ta ndryshojë rrënjësisht BE-në, duke e transformuar atë në mënyrë të vendosur në një lojtare gjeopolitike, dhe në fakt në kundërshtarin kryesor të Rusisë në kontinent.


Me luftën e tij në Ukrainë, presidenti rus Vladimir Putin e ka bërë absolutisht të qartë se synon të rindërtojë Perandorinë Ruse. Dhe në këtë funksion, ai po vepron mbi parime që janë krejtësisht të papajtueshme me ato të Bashkimit Evropian, që bazohet në sovranitetin e barabartë, integritetin territorial, paprekshmërinë e kufijve dhe sundimin e ligjit. BE-ja ka vendosur ta pranojë Ukrainën në gjirin e saj jo sepse do, apo sepse ka ambicet sajperandorake, por sepse Putini e detyroi të vepronte kështu. Presidenti rus nisi luftën, duke e vënë Evropën përballë një zgjedhjeje midis dy alternativave të qarta: Ose Evropa do t'i nënshtrohet pretendimeve të Kremlinit për pushtet, ose mund të mbrojë identitetin dhe interesat e saj, bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut dhe parimeve demokratike. BE-ja ka bërë tashmë zgjedhjen e saj, duke favorizuar mbrojtjen e parimeve të veta dhe ato të lirisë. Disa kritikë të vendimit të saj, do të thonë se ajo duhej të ishte përpjekur të negocionte me Rusinë. Por argumenteve të tilla u

mungon besueshmëria. Edhe nëse Brukseli do të ishte gati të ndërmjetësonte një kompromis të dyshimtë me Kremlinin, kjo nismë nuk do të kishte funksionuar, pasi BE-ja ndodhet aktualisht në një pozicion që është reciprokisht përjashtues nga ai i Putinit, dhe që bazohet në ëndrrën e tij revizioniste për rindërtimin e perandorisë ruse. Meqë asnjëra palë nuk mund të dorëzohet, ne duhet të parashikojmë një konflikt të zgjatur. Dhe duke qenë se forca ushtarake dhe aftësitë parandaluese, do të luajnë në mënyrë të pashmangshme një rol vendimtar, lufta do të ndryshojë përfundimisht edhe karakterin e BE-së. Projekti i integritimit ekonomik, nuk do të jetë më aq krenar për vlerat që bart. Që tani e tutje, siguria dhe interesat gjeopolitike, duhet të jenë të parat në listë. Deklarata e mbështetjes për kandidaturat e Ukrainës dhe Moldavisë, shënon fillimin e fazës së dytë të zgjerimit të BE-së drejt lindjes. Edhe pse pranimi i asnjërit nga këto 2 vende nuk do të ndodhë së shpejti, vetë procesi do të ketë një efekt të pakthyesëm. Evropa e së ardhmes, nuk do të jetë më e

realizueshme pa shtetet e Evropës Lindore, me kushtin që ato të mbeten të gatshme dhe të afta për t'u bashkuar. Arsyeja është shumë e thjeshtë. Kur vjen koha e një ideje, ajo është e pandalshme. Në të kundërt, një ide, koha e së cilës ka kaluar, mund të zgjasë vetëm nëse mbështetet nga fuqia ushtarake. Madje as ajo nuk do ta shpëtojë në fund. Konflikti i ri mes Evropës dhe Rusisë, ka të bëjë kryesisht me idetë. Është një përplasje ideore midis imperializmit dhe demokracisë. Duke pasur parasysh rëndësinë historike të këtij zhvillimi, evropiano-perëndimorët nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë lloji iluzioni komod në lidhje me rreziqet me të cilat po përballen. Rendi aktual evropian, u ndërta fillimisht rreth synimit të integritimit midis Rusisë dhe Evropës. Por Putin e ka shkatërruar në mënyrë të pakthyeshme këtë projekt. Ajo është tashmë një gjë që i përket së shkuarës. Me luftën në Ukrainë, Evropa po përballlet me një test pjekurie. Ajo gjendet tashmë në një botë të përcaktuar nga rivalitetet e fuqive të mëdha dhe ato bërthamore. Në pëlqen apo jo, këto janë

realitetet gjeopolitike të fillimit të viteve 2020. Në mungesë të një aleance të vazhdueshme me Shtetet e Bashkuara, në gjendjen e saj aktuale të brishtë, Evropa do të ishte shumë e dobët për të mbijetuar në këtë arenë. Atë nuk mund ta shpëtojë vetëm interesat apo vlerat. Alternativa është që Evropa ta pranojë dobësinë e saj aktuale, dhe të kapet pas iluzioneve fantastike. Kjo rrugë e çon drejt nënshtimit dhe varësisë. Ajo nuk mund të shpëtojë të gjejnjë konsideratë të ndërsjellë në një botë të diktuar nga rivaliteti i fuqive të mëdha. Prandaj zgjedhja e vetme reale e Evropës, është të jetë pjesë e aleancave të kujdesshme, të zhvillojë fuqinë e saj, dhe të ndërtojë aftësitë e veta parandaluese. Një strategji koherente për t'i mbijetuar konfliktit të ri ideor, duhet të zëvendësojë sa më parë iluzionet e vazhdueshmejorealiste. Evropa duhet ta pranojë se po jeton në një lagje të rrezikshme.

Shënim: Joschka Fischer,
Ministër i Jashtëm i
Gjermanisë dhe
zëvendës/kancelar në vitet
1998–2005.



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Zyrtare: Mevlan Zeka transferohet te Gjilani

GJILAN, 24 QERSHOR (ER) - Sulmuesi Mevlan Zeka është transferuar te Gjilani. Lajmin e ka dhënë SC Gjilani në "Facebook". Marrëveshja e nënshkruar nga gjakovari është dyvjeçare, me mundësi vazhdimi. "27-vjeçari, i cili luan në pozitën e sulmuesit të krahut, vjen nga radhët e FC Ballkani, teksa ka luajtur në disa klube të tjera në vend dhe jashtë vendit, duke fituar tre tituj kampionë, një herë Kupën e Kosovës dhe një herë tjetër Superkupën e

Kosovës. Të gjithë në SC Gjilani i urojnë mirëseardhje Mevlanit dhe i dëshirojnë sukses në objektivat që klubi ka vënë para, duke nisur nga garat ndërkombëtare", ka njoftuar SC Gjilani. Zeka është transferuar te SC Gjilani pas fitimit të titullit kampion me Ballkanin. Siç ishte thënë në njoftimin për medie të klubit suharekas, lojtari nuk ishte i kënaqur me minutat e ofruar dhe për këtë ka dëshiruar të ndërrojë ambient.



Kupa e Botës 2022: 10 ndeshje të fazës së grupeve që nuk duhen humbur



DOHA, 24 QERSHOR - Tifozët e futbollit anembanë globit mezi presin që Kupa e Botës të nisë në Katar më 21 nëntor. Ngjarja më e madhe sportive në botë sigurisht se do të sjellë edhe një herë momente të shkëlqimit sportiv, ekstatës së fitores dhe dëshpërimit të humbjes. Me 32 kombe që shkojnë në Katar, "The AllStar" nxjerr në pah 10 ndeshje nga faza e grupeve që nuk bën t'i humbisni.

TOP DHJETË NDESHJET:

Senegal - Holandë, grupi A, 21 nëntor
Meksika - Polonia, grupi C, 22 nëntor
Belgjika - Kanada, grupi F, 23 nëntor
Brazil - Serbi, grupi G, 24 nëntor
Angli - ShBA, grupi B, 25 nëntor
Argjentina - Meksika, grupi C, 26 nëntor
Franca - Danimarka, grupi D, 26 nëntor
Spanja - Gjermania, grupi E, 27 nëntor
Portugalia - Uruguai, grupi H, 28 nëntor
Polonia - Argjentina, grupi C, 30 nëntor

Mbappe: Synimi i PSG-së është triumfi në Ligën e Kampionëve

PARIS, 24 QERSHOR - Kylian Mbappe ka përsëritur se objektivi kryesor i Paris Saint-Germainit (PSG) është ta fitojë trofeun e Ligës e Kampionëve për herë të parë në histori, pasi paarritur në finale në vitin 2020 PSG-ja nuk kishte arritur të kalonte në raundin e 16 sezonin e kaluar duke u eliminuar nga Real Madridi. "Fitimi i Ligës së Kampionëve është objektivi i qartë dhe i përcaktuar i PSG-së", ka thënë Mbappe për "BFMTV". Pasi ka kaluar Zlatan Ibrahimoviçin si golashënuesi i dytë më i mirë i PSG-së i të gjitha kohëve, Mbappe ka theksuar se ai aspiron të bëhet



golashënuesi më i mirë në historinë e klubit përpara Edinson Cavanit. "Nëse vazhdoj kështu, nuk ka

asnjë arsye pse nuk mund ta bëj. Do të ishte e pabesueshme nëse mund ta bëja", ka thënë ai.

Ronaldo është gati të largohet nga Manchester Unitedi

MANCHETER, 24 QERSHOR

- Cristiano Ronaldo po përgatitet të largohet nga Manchester Unitedi. Kjo dëshirë e portugezit mendohet se rrjedh për shkak të pasivitetit të "Djajve të Kuqë" në merkaton verore. Pesë herë fituesi i "Topit të Artë" ua ka bërë me dije drejtuesve se e dëshiron një skuadër konkurruese pas vetes në mënyrë që të ndiqet rruga e trofeve. Unitedi nuk e ka bërë asnjë transferim



deri më tani. Tash për tash i interesuar seriozisht është vetëm për Frenkie De Jong.

Ibrahim Dreseviç nënshkruan me Fatih Karagumruk

STAMBOLL, 24 QERSHOR - Ibrahim Dreseviç është zyrtarizuar lojtari më i ri i ekipit turk Fatih

Karagumruk. Lajmin e ka dhënë vetë klubi në rrjetet sociale. Futbollisti i Kombëtares së Kosovës në

Futboll deri më tani luante për skuadrën e njohur holandeze Herenveen. Qendërmbrojtësi është

transferuar në Turqi si lojtar i lirë, pasi i ka skaduar kontrata me ekipin aktual.





Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIONIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Dy (2) Vozitës të kategorisë "C" - KRM "Uniteti"Sh.A Njësia në Skenderaj - i Konkursit të shpallur me datë 07.06.2022

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **25.06.2022.** deri me date **01.07.2022** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejepuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Shkurte Dili shpall të pavlefshme diplomën për kryerjen e shkollës së mesme profesionale të lëshuar nga shkolla e mesme "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.
- ▶ Bujar Saliaga nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Klajda Llagami nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10-11-12 si dhe diplomën dhe certifikatën e testit të maturës "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

